



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:175975

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05731053

C.nr.467/2023

Gjykata Themelore Gjilan - Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarës Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S. Z. nga, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Mustafë Nuhiu, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës - QKMF “Dr.Shaban Geci”, të cilën e përfaqëson Alban Hashani, jurist nga Kamenica, me objekt kontesti kompensimin e tri pagave përcjellëse në pension, me vlerë të kontestit 1131 euro, jashtë seancës, me datë 24.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet në tërësi si e pa bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses S. Z. nga, me të cilën ka kërkuar që të Detyrohet e paditura Komuna e Kamenicës - QKMF “Dr Shaban Geci”, që paditëses në emër të kompensimit të tri pagave përcjellëse në pension t’i paguaj shumën prej **1,131.12 euro**, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m i

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj me datë 16.08.2023, në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës - Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti, kompensimin e tri pagave përcjellëse në pension, me vlerë të kontestit prej 1,131.12 euro. Në padi ka theksuar se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune të e paditura në QKMF në Kamenicë, në pozitën e infermieres, deri më datë 04.03.2022, kur edhe është pensionuar. Bazën ligjore ka theksuar se është në KKS-ës, në nenin 17 paragrafi 5. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë 104 euro për përpilimin e padisë dhe shumën prej 30 euro për taksën gjyqësore për padi.

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditëses.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses me arsyetimin se e paditura nuk ka marrë për obligim anën financiare për përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga KKS dhe kështu nuk ka legjitimitet real pasiv, po ashtu ka theksuar se e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit edhe nga fakti se KKS, ka hyrë në fuqi me dt.12.06.2018, dhe e njëjta ka prodhur efekt juridik për 3 vite, deri më datë 11.06.2021, ndërsa paditësja ka dalë në pension në vitin 2022. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar, ndërsa shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura, mirëpo kontestuese është se a i takon kompensimi i tri pagave pas daljes në pension, si dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor.

Gjykata, për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike kontestimore i mori për bazë këto prova materiale, edhe atë: Vërtetimin nr.08-117, i dt.07.03.2022, mbi pervojën e punes, Vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nr.08-115, i dt.07.03.2023, Vendimin për pagat përcjellëse në pension nr.08-116, i dt.07.03.2022, , të lëshuara nga QKMF “Dr. Shaban Geci” në Kamenicë, në emër të paditëses.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e provave, konform dispozitës së nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK-së), erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar nga fakti se paditësja me datë 04.03.2022, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit të njëjtes i’u është ndërprerë marrëdhënia e punës në QKMF, në Kamenicë (fakt ky i bazuar në Vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nr.08-115, i dt.07.03.2023), kur Kontrata Kolektive Sektoriale e dt.11.06.2018, ka pushuar së vepruari pra me datë 10.06.2021, këtë sipas Mendimit Juridik nr.40/2023, i dt.27.02.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, prandaj gjykata ka vendosur që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar, ngase në kohën kur paditëses i’u është ndërprerë marrëdhënia e punës, KKS nuk ka qenë në fuqi, e nga ky fakt edhe për të paditurën nuk rrjedhë detyrimi për kompensimin e tri pagave përcjellëse në pension për paditësen.

Gjykata nuk pati prova tjera materiale për të shtjelluar, mirëpo edhe po të kishte të njëjtat nuk do ishin me ndikim në vendosje ndryshe, ngase palës paditëse edhe ashtu i mungon baza juridike respektivisht KKS e cekur si më lartë tani më edhe nuk është në fuqi.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 399 parag.1 dhe 2 të LPK-së, me të cilin përcaktohet se “1. Kur

gjkata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija. 2. Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”, e nga ky dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, mirëpo është kontestuese baza juridike.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së, si dhe duke pasur parasysh faktin se paditësi nuk ka pasur sukses në këtë çështje juridike kontestimore.

Duke u bazuar nga të lartcekurat, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjkata Themelore Gjilan – Dega në Kamenicë
Departamenti i Përgjithshëm / Divizioni Civil
C.nr.467/2023, më datë 24.05.2024

Gjyqtarja,
Valbonë Dërvodeli, d.v

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.